

Re: Njoftim për fillimin e procedurës së verifikimit dhe përzgjedhjes së kandidaturës

ILIR KADIU <ilirkadiu76@hotmail.com>

Tue 4/9/2019 11:26 AM

To: Keshilli 1 <keshilli1@ked.gov.al>;

Pershendetje!

Te Nderuar Anetare!

Duke ju falenderuar per punen tuaj, do doja tju beja me dije se duke qene se ka kaluar nje kohe relativisht e gjate nga momenti qe une kam aplikuar per vendin vakant te Anetarit te Gjykates Kushtetuese, une jam angazhuar ne detyra te tjera, ne keto kushte terhiqem nga kandidimi per kete pozicion.

Duke ju uruar suksese ne punen tuaj!

Me Respekt

Ilir Kadiu

From: Keshilli 1 <keshilli1@ked.gov.al>

Sent: Friday, April 5, 2019 1:10 PM

To: ilirkadiu76@hotmail.com

Subject: Njoftim për fillimin e procedurës së verifikimit dhe përzgjedhjes së kandidaturës

I nderuar Z. Kadiu.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar ditën e sotme, datë 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i lartë i Drejtësisë. Ky vendim bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit pranë Gjykatës së Lartë dhe në mjetet e medias.

Njëkohësisht, nëpërmjet këtij njoftimi, Këshilli ju informon, edhe individualisht se, për ju ka filluar procedura e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidaturës për vendin apo vendet vakante në të cilat është shprehur interesi juaj për kandidim.

Prandaj, për të vijuar me kryerjen e procedurave dhe veprimeve ligjore të verifikimit dhe përzgjedhjes së kandidaturës,

Në zbatim të procedurës së parashikuar me ligj, bazuar edhe në pikat 22, 58, 79 dhe 91 të aktit normativ, Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” (botuar në Fletoren Zyrtare nr. 32/2019, të cilin mund ta gjeni edhe në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë pjesa për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi), njoftoheni për detyrimin që të paraqiteni në zyrën e Këshillit që gjendet në selinë e Gjykatës së Lartë, **jo më vonë se data 10.04.2019**. Ky

veprim procedural është hapi i parë pa të cilin nuk mund të vijojë procesi i verifikimit dhe përzgjedhjes së kandidaturës suaj.

Kërkohej nga Ju konfirmimi i menjëhershëm i marrjes në dijeni të këtij njoftimi, po në rrugë elektronike, në të njëjtën adresë elektronike sikurse rezulton më sipër.

Për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi

Vitore Tusha

Anëtar - Relator

Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privileguara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse , përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.